# DËSHMI ARKIVI

**A-455185**
VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Integrimi/ Von der Leyen vjen në Shqipëri në fund të shtatorit, Serbia dhe Bosnja mbeten jashtë turit ball kanik të presidentes së KE-së - Shqiptarja.com |
| ADRESA | `https://shqiptarja.com/lajm/von-der-leyen-vjen-ne-shqiperi-ne-fund-te-shtatorit-serbia-dhe-bosnja-mbeten-jashtw-turit-ballkanik-tw-presidentes-sw-kesw` |
| BURIMI | shqiptarja.com |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 18 shtator 2026, 12:53:23 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 18 shtator 2026, 12:49:49 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `4eac37bacd5920b436bf1a0405cd6143e2ee85cd331921348a1ea91a9c040f0a` |
| TEKSTI | `d547e23243cc58639529c75bdefd46f41e33f177c8d66b38c389f47c9a04be76` |
| PAMJA | `51e46d608146dd300d31862a36cec98c1da1f100781c3551d38b4488188df331` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `d8e7fea3ff1e95ee9eb7142d8d42dabb6ae2f7fe07c5f2562aa46b10c062bc70` |
| E MËPARSHMJA | `431657c6a6b0604803c85d00b6599e4f8070c33d6c3bc2e0388cf45654896d9f` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/d8e7fea3ff1e95ee9eb7142d8d42dabb6ae2f7fe07c5f2562aa46b10c062bc70`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Kosova & Rajoni

# Integrimi/ Von der Leyen vjen në Shqipëri në fund të shtatorit, Serbia dhe Bosnja mbeten jashtë turit ballkanik të presidentes së KE-së

*Presidentja e Komisionit Evropian do të vizitojë Tiranën në kuadër të turneut të saj në Ballkanin Perëndimor, që do të zhvillohet nga 30 shtatori deri më 2 tetor.*



*Ursula von der Leyen dhe Edi Rama*

Redaksia
18 Shtator, 14:45 | **Përditësimi: 18 Shtator, 14:52**

Share Tweet




Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, do të vizitojë Shqipërinë në kuadër të turneut të saj në Ballkanin Perëndimor, i cili do të zhvillohet nga 30 shtatori deri më 2 tetor.

Lajmi u konfirmua nga zëdhënësja e Komisionit Evropian, Arianna Podesta, e cila bëri të ditur se në itinerarin e këtij turneu janë përfshirë Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Kosova, ndërsa Serbia dhe Bosnje-Hercegovina nuk do të vizitohen në këtë fazë.

Sipas Podestës, vizitat në Serbi dhe Bosnje-Hercegovinë janë planifikuar të zhvillohen më vonë, në prag të zgjedhjeve që do të mbahen në këto dy vende.


LEXO EDHE:
**Zv.presidenti i KE: Shqipëria e Mali i Zi në fazë të avancuar drejt anëtarësimit në BE! Zgjerimi i Unionit domosdoshmëri**

> *"Siç tha presidentja në samitin e qershorit, Bashkimi ynë nuk do të jetë i plotë pa Ballkanin Perëndimor. Gjatë bisedimeve me partnerët, ajo do të diskutojë për hapat e nevojshëm në rrugën e këtyre vendeve drejt Bashkimit Evropian, si dhe për procesin e integrimit gradual, të mbështetur nga Plani i Rritjes për Ballkanin Perëndimor", tha zëdhënësja Podesta.*

Ky është turneu i gjashtë i Ursula von der Leyen në Ballkanin Perëndimor dhe zhvillohet pak para publikimit të paketës vjetore të raporteve të progresit për vendet kandidate për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Gjatë takimeve me liderët e rajonit, fokusi do të jetë te procesi i integrimit evropian dhe zbatimi i Planit të Rritjes për Ballkanin Perëndimor.

U.D/Shqiptarja.com

TAG: Ursula von der Leyen | ballkani | Komisioni Europian

Sa e vlerësoni këtë artikull? ★★★★★ 5.0 / 5 (2 vlerësime)

LAJMET MË TË VLERËSUARA

## Komente

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:** 16 Shtator, 14:18

**Haga dënon me 81 vite burg 4 ish-krerët e UÇK-së, si e vlerësoni?**

Të drejtë | Të gabuar | Nuk e di

## Lajme të tjera



Verdikti i Hagës për krerët e UÇK-së, BE mesazh rajonit: Respektoni vendimet, ndihmoni në shërimin e plagëve të së kaluarës

18 Shtator, 18:23



BE propozon një arkitekturë të re sigurie për Evropën: Këshill të ri, protokoll emergjence dhe investime në mbrojtje

17 Shtator, 09:17



IPARD III ende i bllokuar, Komisioni Evropian për Report TV: Nuk kemi afate për hapjen e tyre! Fondet e keqpërdorura duhet të kthehen



Eliza Gjediku

13 Shtator, 12:49



'Blej nga Europa', BE ndryshon rregullat e tenderëve: Përparësi kompanive europiane, kufizime për ofertat kineze

10 Shtator, 16:50



Shqipëria dënon nderimet e Mlladiç në Beograd, Hoxha: Glorifikimi i kriminelëve të luftës bie ndesh me vlerat evropiane

8 Shtator, 20:13



Varrimi me nderime të larta i Ratko Mlladiç, Komisioni Evropian paralajmëron rishikimin e negociatave me Serbinë

8 Shtator, 19:25



BE paralajmëron rishikimin e negociatave me Serbinë pas nderimeve për Ratko Mlladiçin! Von der Leyen: Pamje tronditëse, Bosnja dëbon 2 diplomatë

8 Shtator, 12:56



Von der Leyen do ta vizitojë Ballkanin Perëndimor muajin e ardhshëm, s'ka konfirmim nëse do të ndalet edhe në Serbi

7 Shtator, 19:24



A është vënë në pikëpyetje turneu presidentes së Komisionit Evropian për shkak të Serbisë?

5 Shtator, 17:47







**Incidenti në aeroportin e Lajpcigut, Von der Leyen: Nuk tolerojmë sulme ndaj territorit evropian, BE-ja gati t'i përgjigjet Rusisë! Rutte: Moska nuk na frikëson**

2 Shtator, 13:40

**Alarm për sulme ajrore në Kiev, Costa dhe Stubb evakuohen në një strehë! BE i jep 6.1 miliardë euro Ukrainës për mbrojtje, Von der Leyen: Rrisim angazhimin tonë! (VIDEO)**

24 Gusht, 09:58

**Tërmeti 7.4 ballë në Kolumbi, BE jep 2 milionë euro ndihmë për zonat e prekura**

12 Gusht, 13:46

Kodi Etik | Kontakt | Rreth Nesh | Raportoni Ju | Puno me ne

[Shqiptarja.com]

Kerko

© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.